



Prot. N. U/2019/0185

Tiranë, 28 gusht 2019

Komente mbi projektligjin

“Për faturën dhe sistemin e monitorimit të Qarkullimit!

Së pari duam t’ju falënderojmë për organizimin e këtij takimi konsultues, që ka si qëllim të dëgjojë mendimin e përfaqësuesve të biznesit për një ligj kaq të rëndësishëm, i cili padyshim është një lëvizje me prirje pozitive nga pikëpamja e iniciativës ligjvënëse dhe në anën tjetër duket se ka një ndikim mjaft të madh në ambientin e të bërit biznes, sepse ndryshon shumë rregulla në raport me administratën tatimore (dhe jo vetëm), por edhe për shkallën e përfshirjes së teknologjisë në këtë proces.

E kemi lexuar me kujdes të veçantë këtë ligj, duke e diskutuar nen për nen dhe mund të themi me siguri, që secili prej tyre meriton koment. Për të evituar zgjatjen e dokumentit, po shkruajmë në rrafshin e përgjithshëm, pasi kemi një dyshim të madh që palët e përfshira në zbatimin e këtij ligji nuk janë të gatshme për këtë zbatuar këtë ligj, në këtë kohë të trajektorese së ekonomisë shqiptare dhe të biznesit dhe aq më tepër në një afat kaq të shkurtër.

Po rendisim me radhë arsyet:

1. **Ka shumë nene të këtij ligji që kanë paqartësi apo janë të diskutueshme nga pikëpamja teknike.** Kjo duket edhe në faktin që klauzola “Ministri i Financave do nxjerrë udhëzimet përkatëse” përsëritet 31 herë në 49 nene që ka ligji. Biznesi nuk mund të jetë i qartë për të diskutuar një projekt-ligj kur pothuaj 70% e neneve të tij kërkon udhëzim të posaçëm nga Ministri i Financave dhe ky udhëzim nuk është përgatitur akoma. Atëherë s’mbetet gjë tjetër veçse në mungesë të këtyre udhëzimeve, të zhvendosim diskutimin në rrafshin e përgjithshëm. Kujtojmë këtu që Ligji 92/2014 “Për TVSH-në” u miratua në Korrik 2014, për t’u zbatuar në 1 Janar 2015 dhe Udhëzimi i Ministrit doli në 31 Janar 2015 (në shkelje të nenit 159 të këtij ligji), por ajo që është e rëndësishme është fakti që Udhëzimi nuk është frymën e Ligjit, dhe në shumë raste kontradikton me Ligjin dhe subjektet sot që flasim penalizohen më këtë Udhëzim që shtrembëron Ligjin. Ju lutem të mos e përsërisim këtë gabim. **Pra, për të diskutuar na nevojitet Ligji dhe Udhëzimet!**
2. Të gjithë e pranojmë që ka informalitet, ka evazion dhe nëse iniciativa ligjvënëse ka menduar se ky ligj do të forcojë luftën kundër informalitetit dhe evazionit fiskal, shtrojmë pyetjet: Me aq shumë/pak analiza që mund të jenë bërë deri tani, **a mund t’ju përgjigjemi me të dhëna të sakta pyetjeve të mëposhtme** si psh:
 - Sa i matshëm dhe në çfarë përmasash është fenomeni i informalitetit/evazionit. Pra sa e sëmure është ekonomia shqiptare nga ky fenomen?
 - Cilët janë sektorët më të prekur nga ky fenomen, ndërtimi, tregtia, shërbimet, transporti, etj?
 - Cilët kategori biznesesh janë më aktivë në këtë fenomen (B. Vogël, B. Mesëm, apo Korporatat e mëdha; prodhuesit apo tregtuesit importuesit apo shërbimet)?
 - Cilat janë format më tipike të shfaqes së këtij fenomeni dhe si arrijnë të fshihen apo kamuflohen ato?



- Cili është roli i administratës tatimore dhe agjencive të tjera parandaluese dhe ndëshkuese të këtij fenomeni?
- Sa dhe si është investuar në rritjen e kapaciteteve të këtyre institucioneve në këto vite? Po treguesit e rezultateve të këtyre institucioneve si kanë evoluar?
- Cilët janë faktorët më kryesorë që ndikojnë në këtë informalitet/evazion, kultura fiskale, modeli i biznesit dhe i ekonomisë shqiptare, boshllëqe ligjore, paqëndrueshmëria ligjore, dobësia e administratës tatimore, keq orientimi fondave publike, etj?
- Cilat janë rezultatet pozitive dhe negative të reformave të deritanishme, në lidhje me luftën kundër informalitetit?
- E kështu me radhë, mund të rendisim akoma e më shumë pyetje të tjera jo pa rëndësi për temën që po diskutojmë, por që në thelb kanë një çështje të rëndësishme, e cila ka të bëjë me “kulturën fiskale” dhe që të kërkohet kjo nga biznesi, duhet që jo vetëm të ashpërsohen ligjet e biznesit, por edhe të dëgjohen mendimet dhe ankesat e biznesit, e të ofrohet transparencë për procesin e ligjbërjes.

Të kthehemi tek pika “pse mendojmë se ambienti i biznesit në tërësi nuk është gati për këtë ligj”.

3. Projekt-ligi sjell një **ndryshim të madh në mijëra subjekte të vogla dhe të mesme**, të cilat janë të papërgatitura si nga ana financiare, kulturore, infrastrukturore, njerëzore etj. Kosto fillestare do jetë minimalisht 500-1,000 Euro për pajisjet fiskale, shtojtë pastaj kostot vijuese të mirëmbajtjes, konsulencës ose të burimeve njerëzore. Shumë subjekte nuk kanë kapacitete njerëzore për të përmbushur kërkesat e këtij ligji. Subjektet duhet të punësojnë personel më të aftë e më të kualifikuar ose do të marrin konsulencë të jashtme. Të dyja opsionet janë me kosto shtesë.
4. **Infrastruktura aktuale** është e papërshtatshme për një ligj kaq të rëndësishëm dhe të ndjeshëm. Rendisim arsyet:
 - a. Shërbimin e internetit në tërësi dhe jo vetëm tek një linjë interneti dhe një abonimi mujor, por për të gjithë paketën e shërbimit të internetit, përfshi cilësinë e duhur, sigurinë e duhur, vijimësinë e shërbimit dhe aftësinë e riparimit në kohë në rast defektesh nga ofruesit e shërbimit. Edhe kjo përbën kosto shtesë për biznesin.
 - b. Mungesa e kapacitetit teknik të institucioneve përkatëse (Tatime dhe AKSHI). Sapo u kalua nga biznesi një fushatë e lodhshme e deklarimit të Pasqyrave financiare nëpërmjet platformës e-Albania e cila linte shumë për të dëshiruar, si nga pikëpamja hardware/software, ashtu edhe nga aftësia e kapaciteti i këtyre institucioneve për të zgjidhur problemet e raportuara nga subjektet. Mendojmë se arsyeja ishte nxitimi për ta aplikuar sa më parë, duke anashkaluar fazën testuese, përgatitore dhe mungesa e kapacitetit teknik që kërkojnë këto iniciativa të teknologjisë bashkëkohore.
 - c. Fluksi i problemeve që do të krijohen dhe nevojës urgjente për t’i dhënë zgjidhje këtyre problemeve në kohën reale të zbatimit, do të jetë shumë i madh dhe përtej kapaciteteve. Vetë administrata publike mund të jetë e papërgatitur për të ndihmuar në zgjidhjen e problemeve dhe në zbatimin e këtij ligji.
5. **Koha shumë e shkurtër**. Kemi vetëm katër muaj përpara, por po të heqim ditët e festave zor se mbeten 3 muaj kohë. Në datën 1 Janar 2020, biznesi duhet të ketë gati si pajisjet fiskale, ashtu dhe programet përkatëse (ose software) pa prova, pa testime, pa kolaudime, drejt dhe në transmetim LIVE! Në situata të tilla të ngjashme përpilohen projekte zbatimi



me hapa konkretë, si psh: testimi, pilotim, monitorim, kolaudim, paralel running, etj, që në rastin konkret nuk janë parashikuar. Do të shfaqen vështirësi si për programet lokale vendase, dhe aq më tepër për ato që janë universale ose ndërkombëtare, sepse disa prej tyre kanë protokolle mjaft specifike për të bërë ndryshime apo përshtatje. Duke shtuar edhe kostot që duhet të paguajë biznesi në këtë rast.

6. Eksperienca nga aplikimi i këtij ligji në vendet e EU-së.

Duhet të sqarojmë se **Direktiva 2014/55/EU** flet për faturat elektronike në procesin e prokurimeve publike, pra në marrëdhëniet Biznes me Qeveri dhe po të marrim në konsideratë palët në një transaksion tregtar, vetë transaksionet do të ndaheshin në sa vijon:

- a. B2G – Business to Government
 - b. B2B – Business to Business
 - c. B2C – Business to Consumers
- i. Direktiva u dha 4 vite e gjysëm kohë vendeve anëtare të EU, kurse ne duam ta aplikojmë për më pak se katër muaj.
 - ii. Direktiva kërkon aplikimin fillestar tek kategoria B2G, kurse projektligji parashikon aplikimin fillimisht për B2C e më vonë për B2G e B2B.

Megjithatë në vijim të një kërkimi të thelluar në lidhje me aplikimin e kësaj Direktive dhe të faturimit elektronik në veçanti në vende të ndryshme anëtare të EU rezulton se të dhënat deri në korrik 2019 janë:

Tabela:

Directive 2014/55/EU of April 2014				
Country	B2G obligations / Transactions	B2B Transactions	B2C Transactions	VAT live invoicing
Austria	Jan-14		NO	NO
Belgium	Jan 2018 B2G only transactions above E136K	NO	NO	NO
Croatia	July 2019, B2G mandatory invoicing	NO	NO	NO
France	2017-2020 B2G optional	NO	NO	NO
Germany	2017-2020 B2G	NO	NO	NO
Greece	Jan 2020 B2G	Proposal on Jan 2020	Proposal on Jan 2020	Proposal on Jan 2020
Hungary	July 2018	July 2018	July 2018	July 2018
Italy	Jan 2015 e-invoice	Jan 2019 near live invoicing	Jan 2019 near live invoicing	Jan 2019 near live invoicing
Poland	April 2019	NO	NO	NO
Portugal	July 2019 with invoice pre-approval	NO	NO	NO
Spain	Jan 2015 invoices above E5,000	NO	NO	NO
Sweden	April 2019	NO	NO	NO
UK	No Plans	No Plans	No Plans	No Plans



Siç shihet nga tabela, vetëm 2 vende kanë përparuar me zbatimin e këtij ligji, që janë Hungaria dhe Italia, por ende nuk ka dhëna për rezultatet e implementimit.

7. Specifikojmë se ky ligj ka nevojë të studiohet më mirë nga hartuesit, të konsultohet më gjerësisht, në mënyrë që të përgatitet sa më mirë për zbatim, dhe nga ana tjetër, ti jepet kohë biznesit të përgatitet dhe ta studiojë më mirë versionin e plotë të tij bashkë me udhëzimet përkatëse të KM, MoF dhe të AKSHI-t. Të merren parasysh dhe kostot shtesë që do t'i rëndojnë biznesit, dhe pse jo, vetë administrata publike të bëjë një analizë kosto-përfitim për veten e saj. Me futjen e këtij ligji, përveç të tjerash, subjektet do harxhojnë më shumë kohë dhe energji sesa më parë, si në fazën zbatuese (real time invoicing), ashtu dhe me zgjidhjen e problemeve që do krijojë zbatimi i tij, dhe me të drejtë mund të pyesim; **si do të shpërblehet për biznesin kjo kohë e harxhuar më tepër?**
8. Për sa i përket nenit 7 pika 1; Neni 8, pika 1 dhe pika 5; Neneve 9-12, 14, 15, 20, 22, 25, 30, 31, 32, 38,39 etj., të cilët kanë të bëjnë me afate, me kërkesa, dhe protokolle burokratike, në lidhje me lëshimin e faturës, korrigjimin e tyre, apo me rastet e defekteve teknike etj, kemi bindjen se biznesi nuk është gati për këto ndryshime!